

VENDIM
Nr. 424, datë 15.5.2013

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË SHTETEVE, SHTETASIT E TË CILËVE HYJNË PA VIZË NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË PËR PERIUDHËN 25 MAJ DERI MË 25 SHTATOR 2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 2 të nenit 30 të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së shteteve, shtetasit e të cilëve hyjnë pa vizë në Republikën e Shqipërisë, me dokumentin pasaportë, për periudhën 25 maj deri më 25 shtator 2013, si më poshtë vijon:

- Rusia;
- Kuvajti;
- Katari;
- Emiratet e Bashkuara Arabe;
- Arabia Saudite;
- Bahrein.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha